



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 07 .**

Prishtinë, më 19.01.2018 në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: zëvendëskryetari i parë- Xhelal Sveçla, anëtarët e tjerë: Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli dhe Mufera Sinik.

Munguan: Igor Simiq, Danush Ademi dhe Duda Balje.

Nga pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues nga KDI-ja, Artan Murati; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Në këtë mbledhje, morën pjesë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

Emri i stafit mbështetës të komisionit, Drita Çarkaxhiu -zyrtare e lartë e fushës.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i parë i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Rendi i Dites:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.12.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-0005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;**
- 4. Të ndryshme.**

Zëvendëskryetar, Xhelal Sveçla, në fjalën e tij hyrëse tha se sot mungon kryetari i komisionit andaj unë do të udhëhoqi këtë mbledhje.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Zëvendëskryetari, hodhi në votim rendin e ditës, dhe konstatoi se e njëjta miratohet nga anëtarët e komisioni, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.12.2017

Zëvendëskryetari, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.12.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-0005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa

Zëvendëskryetari, theksoi se është kërkesë urgjente për procedimin e Projektligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, në Seancën plenare të radhës, për këto arsye:

Projektligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme do vendosë themelet dhe do t'i hapë rrugën materializimit të një reforme, e cila ka një rëndësi jetike për Komunitetin e Kosovës dhe është kusht që Qeveria e Kosovës të përfitojë financim (një grant rreth 5.000.000 euro) për asistencë nga Qeveria Suedeze për zbatimin e reformës së re në tatimin në pronën e paluajtshme. Për këtë arsye asistencë e eksperteve Suedeze është e domosdoshme.

Nëse projektligji nuk miratohet sa më shpejt brenda këtij muaji (janar 2018) ky grant rrezikon të mos përfitojë Qeveria e Kosovës, për shkak të procedurave vjetore të planifikimit buxhetor nga ana e SIDE-s Suedeze.

Miratimi sa më i shpejtë i projektligjit dhe fillimi i përgatitjeve teknike përfshirë, hartimin e akteve nënligjore do të shërbente në përcaktimin e rregullave, kushteve teknike dhe procedurave të hollësishme rigorozë, gjatë procesit të administrimit të tatimit në pronën e paluajtshme, me qëllim sigurimin e një procesi administrativ të drejtë, ligjor, transparent dhe efikas. Për më shumë plotësimi i kushteve teknike të nevojshme dhe kuadrit ligjor në kohë do të bënte ligjin, tërësisht të zbatueshëm.

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme me Raport amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa. Ky Raport përmban tri lloje amendamentesh, dhe për mënyrën e votimit, paraqiti dy propozime: amendamentet të votohen një nga një, apo të votohen në grupe; nën një, amendamentet e Komisionit Funkcional, nën dy të Grupit Parlamentar të Listës Serbe dhe nën tre të deputetes Evgjenie Thaçi-Dragusha. Pas diskutimeve, anëtarët e komisionit u deklaruan që Raporti me amendamentet të komisionit Funkcional të votohen në grupe.

Zëvendëskryetari, fillimisht i hodhi në votim amendamenteve të Komisionit Funkcional për buxhet dhe financa, dhe konstatoi se komisioni i miratoi të njëjtat, pa ndryshime.

Me theks të veçantë tha se amendamentet e Listës Serbe nuk kanë marrë përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe për sqarime të detajuara, fjalën ia dha përfaqësuesit të Ministrisë së Financave.

Shkelzen Morina - drejtor i departamentit për tatimin në pronë, tha se amendamentet e propozuara nga GP i Listës Serbe, nuk kanë marrë përkrahjen e Komisionit Funkcional sepse të njëjtat janë të përfshira në Ligj.

Sa i përket hartimit të Draf- Ligjit, qasje direkte kanë pasur përfaqësuesit serbë të Komunitetit të Graçanicës dhe të Shtëpcës, të cilët kanë shtjelluar në formën më të mirë të mundshme në bashkëpunim me OSBE-në, Fondin Monetar Botëror dhe Ambasadën Amerikane, konform direktivave dhe standardeve më të larta.

U përqendrua në nenin 17 të projektligjit, i cili ka të bëjë me vlerësimin e pronave të paluajtshme me ç' rast Ministri i Financave është kompetent të themelojë Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e vlerësuesve të pronave të paluajtshme. Përzgjedhja e emërimit të anëtarëve të këshillit bëhet nga ministritë përkatëse në bazë të profesionalizmit. Kryetarin dhe anëtarët e këshillit i emëron dhe shkarkon Ministri i Financave.

Në ligj ceket shumë qartë se çdo qytetari që nuk iu është mundësuar qasja në pronën e vet, ai lirohet prej tatimit, por paraprakisht duhet të marrë një konfirmim prej Agjencisë për Verifikim të Pronës, Gjykatës dhe Komunës.

Jasmina Zhiković, tha se sa i përket amendamenteve të GP të Listës Serbe, është dhënë propozim që në nenin 17, të shtohet paragrafi 4,6 me tekstin: të zgjidhen dy përfaqësues të komunitetit serb dhe një përfaqësues i komuniteteve të tjera.

Në fjalën e saj tha se qytetarët e komunitetit serb, janë parapagues të rregullt të tatimit në pronë dhe ata duhen të jenë të përfaqësuar në këto mekanizma. Veçoi, se nga dhjetë komunat e banuara me shumicë serbe, mund të gjenden profesionistë të cilët në mënyrë adekuate do t' i përgjigjen detyrave që kërkohet me këtë Ligj. Proces ky i cili është shumë i rëndësishëm për vlerësimin e pronave të paluajtshme për komunitetet që jetojnë në Kosovë. Ajo është e interesuar të informohet pse të njëjtat nuk e kanë marrë miratimin e Komisionit Funkcional.

Mufeta Srbica Shinik, diskutoi lidhur me amendamentin 9, i cili është propozuar nga GP i Listës Serbe, konkretisht pika 4,6 ku shkruan se duhet të zgjidhen dy përfaqësues të komunitetit serb dhe një përfaqësues të komuniteteve të tjera, për të cilin emërtim ka vërejtje. Pra, duhet të definohet emërimi të komunitetit joshumicë apo pakicë, në të kundërtën bie se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kujtim Shala, tha se ky komision ka për qëllim që të mbrohen të drejtat autentike të komuniteteve. Në bazë të diskutimeve shihet se paragjykimet janë të pavend sepse nuk bëhet fjalë për ndonjë vendim, por sipas Ligjit ekziston skema e cila është në përbërje prej shtatë institucione dhe secili prej tyre vendose për përzgjedhjen e një përfaqësuesi profesional.

Ai i rikujton se duhet t' i përmbahemi tekstit të ligjit. Në bazë të Ligjit, ministritë përkatëse emërojnë anëtarët për të bërë vlerësimin e pronave të paluajtshme. Kompetencat e përfaqësuesve janë zbatimi i procedurave të vlerësimit, e jo në baza të përkatësisë etnik, në të kundërtën do të konsiderohet shkelje procedurale. Këto janë arsyet e vetme pse nuk i përkrah amendamentet e Listës Serbe.

Sasha Milosavljević, tha se sa i përket çështjes së vlerësimit të pronave të paluajtshme, nuk është korrekte nga ana e ministrive përkatës të mos emërojnë asnjë anëtarë të komunitetit shumicë apo të komunitetit joshumicë, kjo situatë është brengosëse për komunitetet. Kërkesa e tij ishte që komisioni të marrë parasysh shqetësimet tona dhe të japë pëlqimin për miratimin e amendamenteve të Grupit Parlamentar të Listës Serbe.

Jasmina Zhivković, përsëri diskutoi, se amendamentet e propozuara nga GP e Listës Serbe janë hartuar me qëllimin më të mirë, që gjatë vlerësimit të pronave të paluajtshme të ketë përfaqësues të komunitetit shumicë dhe të atyre pakicë, e drejtë kjo e cila u garantohet me Kushtetutë. Qëndrimi i saj konkret ishte që zgjedhja e përfaqësuesve të komuniteteve, të përcaktohet me këtë Ligj. Në fund, luti anëtarët e komisioni të japin përkrahje për miratimin e amendamenteve të propozuara nga GP i Listës Serbe.

Zëvendëskryetari, tha se nëse vlerësohet se ka shkelje Kushtetuese, është e drejtë e juaja që ankesën ta procedoni në Gjykatën Kushtetuese. Ai nënvizoi se nuk bëhet fjalë për shkelje ligjore nga se Ligji është shumë i qartë, procesi i administrimit të tatimit në pronën e paluajtshme do t' i japë organeve përgjegjëse të gjitha atributet ligjore dhe institucionale për administrimin dhe monitorimin e funksionimit në përgjithësi të tatimit në pronë dhe zgjedhja e kandidatëve për vlerësim bëhet në bazë të profesionalizmit.

Për këto institucione, nuk është pengesë që të bëjnë zgjedhjen e anëtarëve edhe të komunitetit shumicë apo atij pakicë, por mbetet si çështje thelbësore që zgjedhja e anëtarëve të bëhet në bazë të aftësisë profesionale.

Albert Kinolli, ishte i mendimit se pati keqkuptime për gjatë diskutimeve. Në kuadër të hapjes së konkursit, sipas Ligjit, si kriter kryesor është zgjedhja e anëtarëve në bazë të profesionalizmit, dhe të drejtë aplikimi kanë secili kandidat pa marrë parasysh cilit komunitet i përket. Nëse me Ligj obligohet zgjedhja e përfaqësuesit sipas etnitetit, del se çështja e profesionalizmit bie në rendin e dytë.

Zoran Mojsilović, bazua në përvojat e mëhershme, tha se nëse me Ligj nuk rregullohet zgjedhja e anëtarëve për vlerësimin e pronave të paluajtshme, atëherë kjo çështje ndikon negativisht për komunitetin tonë. Situata e krijuar, dëshmohej me faktin se nuk janë miratuar amendamentet e propozuara nga Lista Serbe nga ana e Komisionit Funkcional për buxhet dhe financa. Këtë janë arsytet e pakënaqësive tona, për të cilat kërkojmë që ky komision të ketë mirëkuptim dhe të votohen propozimet e GP të Listës Serbe.

Mufera Serbica Shinik, kërkoi të informohet lidhur me përbërjen dhe funksionalizimin e institucioneve të cilët bëjnë vlerësimin e pronave të paluajtshme.

Shkelzen Morina, dha sqarime shtesë, për zgjedhja e anëtarëve është çështje teknike, secili ministër e bën zgjedhjen në bazë të fushave përkatëse, Pra nuk hapet konkurs, anëtarët e zgjedhur do të kenë një obligim më shumë dhe nuk do të kenë pagë të dyfishtë.

Sipas Ligjit, Ministria e Financave themelon Këshillin Mbikëqyrës për licencimin e poenëve të paluajtshme. Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e vlerësuesve të pronave të paluajtshme është në këtë përbërje; dy anëtarë nga Ministria e Financave, një nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, një nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, një nga Banka Qendrore e Kosovës dhe Shoqata e Bankave, dhe një anëtar nga Oda Ekonomike. Kryetarin dhe anëtarët e këshillit i emëron dhe shkarkon Ministri i Financave.

Për informim plotësues tha, në bazë të projektit ‘SIDE-s’ grant, i cili financohet nga Suedezët në vlerë prej 5000 euro, i cili është në funksion që nga viti 2014 e deri më sot, dhe prej katër komunave, në komunën e Graçanicës dhe të Shtërpcës, në pozitën drejtuese menaxhohet nga komuniteti serb.

Zëvendëskryetari, dha sqarim plotësues, se me këtë Ligj përcaktohen pozitat profesionale të cilat emërohen nga ministrinë e linjës përkatëse, pra rrjedhimisht është çështje teknike.

Ai konsideron se amendamentet e GP të Listës Serbe nuk e kanë marrë miratimin e Komisionit Funkcional sepse të njëjtat përfshihen në Ligj, dhe shtoi, nëse ishin miratuar atëherë normat do të duplikohen.

Zëvendëskryetari, i hodhi në votim amendamentet e Grupit Parlamentar të Listës Serbe, dhe të njëjta u miratuan me **pesë vota Për** dhe **dy vota Kundër**.

Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga deputetja Evgjëni Thaçi - Dragusha, dhe të njëjtat u përkrahën në tërësi.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit Funkcional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Projektligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. A) Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara të Komisionit Funkcional dhe të njëjtat u përkrahu në tërësi.
B) Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe dhe të njëjtat u përkrahën në tërësi.
C) Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga deputetja Evgjëni Thaçi - Dragusha, të cilat u përkrahën në tërësi.

4. Të ndryshme

Rasim Selamanaj, si temë të veçantë ngriti çështjen lidhur me caktimin e ditës për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta. Ai propozoi që të caktohet një ditë e përshtatshme për të gjithë anëtarët e komisionit, nga se shumica e deputetëve janë të zgjedhur në dy apo tre komisione dhe kjo po na sjell avari.

Mufera Serbica Shinik, ajo propozoi që në mbledhje të komisionit, të ftohet Ministri për Arsim, Kulturë dhe Rini, për të dhënë sqarime pse nuk janë zgjedh nga ana e Agjencisë për Akreditim përfaqësues të komuniteteve joshimicë. Kërkesa e saj ishte që kjo çështje të procedohet më tej.

Zëvendëskryetari, theksoi se çështjet e ngritura nga parafolësi do të diskutohen në takimin kur do të jetë prezent edhe kryetari i komisionit dhe bashkërisht do të vendoset për ditën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta.

Gjithashtu, çështja e ngritur nga zonja Myfera, që të ftohet Ministri i Arsimit, Kulturës dhe Rinisë, është parashtruar në pikën në të ndryshme, dhe se kjo çështje proceduralisht nuk mund të votohet, por e njëjtë do të rishqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora 13.20.

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Zëvendëskryetar i komisionit,

Xhelal Sveçla